



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 877/8 Prot.

Durrës, më 13.03 .2025

VENDIM

Nr. 23, datë 13.03 2025

PËR "MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË RIORGANIZUAR MBI MASËN 20% TË CIKLIT TË DYTË, MASTER I SHKENCAVE NË "MËSUESI, GJUHË E HUAJ, GJUHË GJERMANE" NË PROGRAM TË PËRBASHKËT (DIPLOMË E DYFISHTË) NDËRMJET UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës DHE UNIVERSITETIT "CONSTANTINE THE PHILOSOPHER", NITRA, SLOVAKI (UKF).

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr.1, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar udhëzimi i MAS nr.2, datë 21.01.2025 ; në Statutin e UAMD-së, Rregulloren e UAMD-së, vendimi i Senatit Akademik nr.23, datë 11.03.2025, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Riorganizimin mbi masën 20% të programit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Mësuesi, gjuhë e huaj, Gjuhë Gjermane" në program të përbashkët (diplomë e dyfishtë) ndërmjet Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës dhe Universitetit "Constantine the Philosopher", Nitra, Slovakia (UKF), bazuar në pikën 3 kreu IV/A, të Udhëzimit të MAS Nr. 2, datë 21.01.2025, bëhen cilësimet si më poshtë:
 - c) Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën gjermane dhe në gjuhën angleze;
 - d) Kodi i programit të studimit **P-72MS-0231-GA**.
2. Tarifa për këtë program studimi do të jetë 1200 lekë/kredit.
3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

